



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.

Sipas Marrëveshjes Kuadër, nënshkruar më datë 23 nëntor 2020, palët janë:

Pala Blerëse: Unione di Banche Italiane SPA është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë. Unione di Banche Italiane SPA ka objekt kryesor depozitimin e kursimeve dhe ushtrimin i kredisë në format e ndryshme të saj, direkt dhe përmes filialeve. Unione di Banche Italiane SPA kontrollon nga Grupi Intesa Sanpaolo SPA

Intesa Sanpaolo SPA është e pranishme në Shqipëri përmes filialit të zotëruar plotësisht prej saj, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Target: Aviva Vita SPA është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë. Aviva Vita SPA operon si një shoqëri sigurimi ekskluzivisht në shtetin italian.

Palët Shitëse: Aviva Italia Holding SPA dhe Aviva Italia SPA, shoqëri të themeluara sipas ligjeve të Italisë me objekt kryesor ofrimin e sigurimeve të kredisë, mbrojtje investimesh, bono dhe shërbime të tjera sigurimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.